



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1909 prot.

Shkodër, më 18.05.2026

V E N D I M

Nr. 150, datë 18.05.2026

**“PËR MIRATIMIN E ZGJATJES SË MARRËDHËNIES SË PUNËS TË  
ADMINISTRATORIT PËR NJË PERIUDHË 1-VJECARE”**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 51, pika 1; Ligji nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 31 dhe 33; Statuti i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, neni 36, pika 1; shkresës nr.1857 prot, datë 13.05.2026, të Administratorit të emëruar në këtë pozicion me Vendim të BA nr.133 datë 23.04.2026, për zgjatjen e marrëdhënies së punës pasi me datë 20.05.2026 mbushë moshën e daljes në pension; duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij pozicioni kyç në mirëfunksionimin e USH-së dhe pasojat negative që mund të sjellë ndërprerja e marrëdhënies së punës në këtë fazë; faktin që ligji e njeh konceptin juridik dhe social “pension pleqërie” si e drejtë dhe jo detyrim, duke parashikuar njëkohësisht edhe të drejtën e shtyrjes së moshës së daljes në pension, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 18.05.2026,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shtyrjes së moshës së daljes në pension pleqërie për një kohëzgjatje 1 (një) vit kalendarik.
2. Administratori nënshkruan kontratë pune në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, me afat të caktuar 1 (një) vit kalendarik.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim i dërgohet për dijeni Senatit Akademik, Rektorit të USH-së, dhe z. Mark Molla.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetari i Bordit të Administrimit**

**Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka**

